

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Praktika e Auditimit të
Brendshëm
Internal Audit Practice**

B3

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 03.02.2018

CONTENT / PËRMBAITJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Total	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

1. Roli i duhur organizativ i auditimit të brendshëm është të:
 - A. Ndhimj auditorin e jashtëm me qëllim të zvogëlimit të tarifave të auditimit të jashtëm.
 - B. Kryej studime për të ndihmuar në arritjen e operacioneve më efikase.
 - C. Shërbej si krah hetues i komitetit të auditimit të bordit të drejtorëve.
 - D. Shërbej si një funksion vlerësimi për të shqyrtuar dhe vlerësuar aktivitetet si një shërbim ndaj organizatës.

2. Si pjesë e procesit për të përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet auditorit dhe të audituarit, është shumë e rëndësishme për t'u marrë me mënyrën se si perceptohet auditimi i brendshëm. Disa lloje të qëndrimeve në punën e kryer do të ndihmojnë në krijimin e këtyre perceptimeve. Nga perspektiva e menaxhmentit, cili qëndrim ka të ngjarë të jetë më i favorshëm për një perceptim pozitiv?
 - A. Objektiv.
 - B. Hulumtues.
 - C. Pyetës.
 - D. Konsultativ.

3. Për të shmangur krijimin e konfliktit ndërmjet Drejtorit Ekzekutiv (CEO) dhe komitetit të auditimit, drejtori i auditimit të brendshëm duhet të:
 - A. I dërgojë kopjet e të gjitha raporteve të auditimit tek Drejtori Ekzekutiv (CEO) dhe komiteti i auditimit.
 - B. E forcojë pavarësinë përmes statusit organizativ.
 - C. I diskutojë të gjitha raportet e pakryera për Drejtorin Ekzekutiv (CEO) me komitetin e auditimit.
 - D. I kërkoj bordit krijimin e politikave që mbulojnë marrëdhëniet e auditimit të brendshëm me komitetin e auditimit.

4. Udhëheqësi i ekipit të auditimit ka më pak të ngjarë të ketë rol parësor në:
 - A. Alokimin e orëve të buxhetuara të auditimit ndërmjet stafit të caktuar.
 - B. Përditësimin e dosjeve të përhershme.
 - C. Rishikimin e dokumenteve të punës.
 - D. Përgatitjen e fletës së kritikës për auditimin.

5. Cili mjet i planifikimit të auditimit është i përgjithshëm në natyrë dhe përdoret për të siguruar mbulim adekuat të auditimit me kalimin e kohës?
 - A. Plani afatgjatë.
 - B. Programi i auditimit.
 - C. Buxheti i departamentit.
 - D. Statuti i departamentit.

6. Përparësia që i atribuohet krijimit të zyrave të auditimit të brendshëm në terren për punë në vende të largëta përshkruhet më së miri si:
 - A. Mundësia e rritjes së objektivitetit të personelit të caktuar në një zyrë në terren.
 - B. Një reduktim i kohës së udhëtimit dhe shpenzimeve të lidhura me udhëtimin.
 - C. Lehtësia në rritje e mbajtjes së standardeve uniforme të kompanisë.
 - D. Më shumë kontakte me personelin e lartë të auditimit çojnë në një rritje të kontrollit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

7. Kritika e fundit ndaj departamentit të auditimit të brendshëm theksoi se mbulimi nga auditimi nuk është duke ofruar reagim adekuat për menaxhmentin e lartë në proceset e përdorura në linjat kryesore të biznesit. Problemi u definua më tutje si mungesë e reagimit (feedback) në implementimet aktuale të sistemeve të automatizuara të ndihmës. Cilat janë dy funksionet që drejtori i auditimit të brendshëm duhet t'i përmirësojë?
- A. Mbulimi me staf dhe komunikimi.
 - B. Mbulimi me staf dhe vendimmarrja.
 - C. Planifikimi dhe organizimi.
 - D. Planifikimi dhe komunikimi.
8. Gjatë kryerjes së një auditimi, një auditor i brendshëm informohet për veprimet e paligjshme që kryhen nga disa prej zyrtarëve më të lartë të kompanisë. Kujt duhet t'i adresohen gjetjet e raportit të auditimit?
- A. Mbikëqyrjes të nivelit horizontal (të njëjtë).
 - B. Anëtarëve të departamentit për media.
 - C. Zyrtarëve të përfshirë në aktet e paligjshme.
 - D. Komitetit të auditimit të bordit të drejtorëve.
9. Një shef i auditimit të brendshëm zbulon një aktivitet mashtrues mjaft të rëndësishëm që përfshin në mënyrë të qartë zëvendës drejtorin ekzekutiv të cilit shefi i auditimit i raporton. Cila nga të mëposhtmet më së miri përshkruan se si duhet të veprojë shefi i auditimit të brendshëm?
- A. Kryen një kontroll me qëllim të përcaktimit të shkallës së mashtrimit.
 - B. Interviston zëvendës drejtorin ekzekutiv për të marrë dëshmi të nevojshme.
 - C. Njofton autoritetet rregullatore dhe policinë.
 - D. Raporton faktet tek drejtori ekzekutiv dhe komiteti i auditimit i bordit të drejtorëve.
10. Një auditor i brendshëm është duke intervistuar tre individë, një prej të cilëve është i dyshuar për kryerjen e një mashtrimi. Cila nga të mëposhtmet është qasja më pak efektive e intervistimit?
- A. Kërkesa ndaj secilit individ për të përgatitur një deklaratë me shkrim që shpjegon veprimet e tij ose të saj.
 - B. Marrja e rolit të personit që kërkon të vërtetën.
 - C. Dëgjimi me kujdes atë që ka për të thënë i intervistuari.
 - D. Përpjekja për të shtyrë të dyshuarin të rrëfejë.
11. Auditori i brendshëm është përgjegjës për raportimin e mashtrimit tek menaxhmenti i lartë ose bordi kur:
- A. Me një siguri të arsyeshme janë përcaktuar shumtë materiale të rastit të mashtrimit.
 - B. Aktivitete të dyshimta janë raportuar në auditimin e brendshëm.
 - C. Transaksionet e parregullta janë identifikuar dhe janë nën hetim.
 - D. Rishikimi i të gjitha transaksioneve të dyshuara për mashtrim është përfunduar.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

12. Një kompani kohët e fundit hyri në një kontratë kosto-plus për të ndërtuar një fabrikë të re dhe më të madhe të prodhimit. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të kishte rëndësinë më të madhe për auditorin që shqyrton këtë kontratë?
- A. Rishikimi i kontratës për të konstatuar se përmban një dispozitë për të drejtën e rishikimit të sistemit dhe auditimin e kostos së kontraktorit.
 - B. Rishikimi i kontratës për një datë të caktuar të përfundimit.
 - C. Rishikimi i kontratës dhe i të gjitha ofertave përkatëse të marra për të konstatuar se kompania ka zgjedhur kontraktorin me ofertën më të ulët.
 - D. Rishikimi i integritetit të biznesit të kontraktuesit përmes hetimit të drejtpërdrejtë.
13. Auditorët e brendshëm ndonjëherë shprehin opinione në raportet e auditimit, përveç deklaratimit të fakteve. Kujdesi i duhur profesional kërkon që opinionet e auditorit të jenë:
- A. Të bazuara në prova të mjaftueshme faktike që garantojnë shprehjen e opinioneve.
 - B. Të bazuara në përvojën dhe në asnjë mënyrë të njëanshme.
 - C. Të shprehura vetëm kur kërkohen nga i audituari ose menaxhmenti ekzekutiv.
 - D. Të kufizuara në efektivitetin e kontrolleve dhe përshtatshmërinë e trajtimeve kontabël.
14. Një kontrollues i kompanisë është i shqetësuar se pjesët mund të vidhen sepse nuk ka funksion formal të pranimit (dmth., fletëpranimet nuk plotësohen). Lëndët e para të prodhimit zhvendosen nga makineria hekurudhore direkt në linjën e prodhimit dhe pala shitëse (furnitorët) paguhen bazuar në prodhimin aktual. Cili nga komentet në vijim, saktë portretizon procesin aktual?
- I. Mallrat mund të paguhen vetëm nëse ato janë përdorur në prodhim. Mallrat e vjedhura ose mallrat që nuk janë transportuar nuk do të paguhen.
 - II. Ka më pak dorëzim të mallrave të marra, duke zvogëluar kështu koston e përpunimit të mallrave të pranuar si dhe uljen e mundësive për gabime për regjistrime hyrëse në sistem.
 - III. Mungesat e materialeve të ia tërheqin vëmendjen mbikëqyrësit për shkak të ndaljeve të prodhimit.
- A. Vetëm I
 - B. Vetëm II
 - C. Vetëm III
 - D. I, II dhe III
15. Softueri i fletëve llogaritëse elektronike 'spreadsheet' do të ishte më i përshtatshëm për cilën nga aktivitetet e mëposhtme të auditimit?
- A. Përgatitjen e sllajdeve për një prezantim të auditimit.
 - B. Përgatitjen e raportit narrativ që përmbledh rezultatet e një auditimi.
 - C. Përgatitjen e planit të zhvlerësimit për pasuritë jo-qarkulluese (asetet fikse).
 - D. Ngarkimin e të dhënave nga një mikrokompjuter në një kompjuter kryesor.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

16. Një organizatë shet produkte nëpërmjet katalogut dhe merr porosi nëpërmjet telefonit. Të gjitha urdhresat e porosive regjistrohen online dhe objektivi i organizatës është të dërgojë të gjitha porositë brenda 24 orëve. Gjurmët e transaksioneve mbahen në formë të lexueshme në makinë. Ddokumentet e vetme të gjeneruara janë fletëpaketimet dhe faturat e dërguar tek klienti. Të hyrat regjistrohen në kohën e dërgimit të mallrave. Organizata mban një databazë të hollësishme të konsumatorëve që iu lejon konsumatorëve të kthejnë mallrat në çdo kohë.

Auditori dëshiron të përcaktojë se vetëm menaxheri i marketingut dhe personeli tjetër i caktuar në departament kanë miratuar ndryshime në çmimin e produkteve në databazën e produktit. Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit do të ofrojë dëshmi më bindëse mbi efektivitetin e kontrollit lidhur me ndryshimet e çmimeve?

- A. Përdorimi i një strukture të integruar testimi (ITF) dhe dorëzimi i porosive të produktit në ITF. Krahasimi i çmimeve të faturuara me çmimet në katalogun e fundit.
- B. Përdorimi i teknikës së auditimit 'Sistemi i kontrollit të dosjeve të rishikuara të auditimit' (SCARF) për të krijuar një listë të të gjitha porosive të klientëve që tejkalojnë kufirin e përcaktuar shumë në euro dhe printimi i rezultateve për hetime të mëtejshme.
- C. Marrja e një kopje të të gjitha ndryshimeve të autorizuara të çmimeve dhe gjurmimi manual në edicionin aktual të katalogut të organizatës.
- D. Marrja e një regjistri të kompjuterizuar të të gjitha ndryshimeve të bëra në databazën e çmimeve. Marrja e një mostre të rastësishme të ndryshimeve dhe gjurmimi deri tek dokumenti i nënshkruar nga personi që autorizon ndryshimin.

17. Një kompani që ofron vegla elektrike regjistron shpenzimet kapitale dhe të mirëmbajtjes përmes përdorimit të një sistemi kompjuterik të përcjelljes së projektit. Puna, materiali dhe shpenzimet e përgjithshme janë ngarkuar në numrin relevant të projektit. Si rrjedhojë, prodhohen raporte mujore të cilat detajojnë regjistrimet individuale për secilin projekt dhe shuma e shpenzimeve jepet për muajin aktual, vitin fiskal dhe jetën e projektit deri më sot. Një auditor është duke shqyrtuar raportet mujore të shpërndara nga personeli i Sistemit Informatik të Menaxhimit (MIS) për të përcaktuar nëse qasja në informata konfidenciale është e kufizuar për mbikëqyrësit e projektit. Cilin nga hapat e mëposhtëm duhet të ndërmerr auditori?

- I. Rishikon një mostër të treguesve të raportit përfundimtar të punës.
- II. Përcakton nëse raportet nënshkruhen në kohën e dorëzimit.
- III. Rishikon kodin e gjuhës së sistemit operativ të kontrollit të punës (JCL) për fundin jonormal (ABEND).
- IV. Verifikoni se është përdorur dosja e saktë e transaksionit.
 - A. I dhe III
 - B. II, III dhe IV
 - C. Vetëm II
 - D. I dhe II

18. Departamenti i mirëmbajtjes së flotës së makinave me qira të kompanisë përdor një kod të ndryshëm për çdo lloj transaksioni të inventarit të pjesëve. Një raport përmbledhës ditor e rendit aktivitetin sipas numrit të pjesës dhe kodin e transaksionit. Raporti harmonizohet nga mbikëqyrësi i flotës së pjesëve me formularët për kërkesat ditore për materiale dhe pastaj i përcillet menaxherit të flotës për miratim. Harmonizimi i raportit përmbledhës me formularët e kërkesave ditore për materiale nga ana e mbikëqyrësit të flotës së pjesëve:

- A. Verifikon që të gjithë formularët e kërkesave për materiale janë miratuar.
- B. Ofron dokumentim se çfarë materiali ka qenë në dispozicion për një transaksion të veçantë.
- C. Konfirmon që të gjithë formularët e kërkesave për materiale janë futur për të gjitha pjesët e lëshuara.
- D. Siguron saktësinë dhe plotësinë e të dhënave hyrëse.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

19. Një organizatë e shitjes me pakicë sapo ka implementuar shkëmbimin elektronik të të dhënave (EDI) për të lëshuar urdhërblerja për furnitorët kryesorë. Zhvilluesi i sistemit ka zhvilluar një bazë të dhënash të furnitorëve të miratuar. Furnitorët e rinj mund të shtohen vetëm pas një rishikimi të hollësishëm nga menaxheri i blerjeve dhe drejtori i marketingut. Vetëm agjentët e blerjeve mund të lëshojnë urdhërblerja dhe shuma e urdhërbljerjeve për një linjë të caktuar produktesh nuk mund të kalojë shumën e buxhetuar të përcaktuar nga menaxheri i marketingut.

Të gjitha blerjet shkojnë në qendrën e shpërndarjes, ku skanohen elektronikisht në sistemin kompjuterik. Të gjithë artikujt hyrës duhet t'i referohen urdhërblerjes së kompanisë dhe artikujt që nuk përmbajnë një referencë të tillë nuk pranohen. Nuk përdoren fletëpranimet me numër të paracaktuar, por të gjitha faturat i referohen urdhër blerjes. Etiketat e çmimit gjenerohen sipas porosisë së blerjes dhe për sasi të shënuara në raportin e pranimi elektronik të skanuar. Numri i etiketave të krijuara të çmimeve përputhet me numrin e produkteve të marra.

Furnitori dërgon një faturë tek shitësi me pakicë. Faturat regjistrohen në sistem. Softueri kompjuterik është i programuar që të përputhe faturën e furnitorit, urdhër blerjen dhe raportin e pranimi. Nëse të tre këto dokumente përputhen brenda një tolerance prej 0.5%, programi kompjuterik i planifikon artikujt për pagesë brenda kohës për të përfituar nga zbritjet në blerje. Çeku gjenerohet nga programi i pagesave me para të gatshme dhe nënshkruhet e dërgohet me e-mail në formë elektronike. Nëse ka një mospërputhje midis të tre dokumenteve, shtypet një raport i cili i dërgohet departamentit të llogarive të pagueshme për hetim.

Cila nga deklaratat e mëposhtme, nëse është e vërtetë, do të kontribuonte në efektivitetin e kontrollit të mjedisit kompjuterik të përshkruar më lart?

- A. Kompania përdor një program të automatizuar të kontrollit të qasjes që identifikon të gjithë përdoruesit, të dhënat dhe veprimet që mund të merren nga përdoruesit.
- B. Vetëm programuesi përgjegjës për kodimin e ndryshimeve zbaton të gjitha ndryshimet e programit.
- C. Agjentët përgjegjës të blerjeve për blerjen e linjave të prodhimit të furnizuar nga furnitori duhet të iniciojnë të gjitha ndryshimet në bazën e të dhënave të furnitorit.
- D. Departamenti i pranimi nuk duhet të ketë qasje në informacionin e porosisë së blerjes.

20. Cila nga të mëposhtmet përshkruan një dobësi të kontrollit?

- A. Procedurat e blerjes janë të mirë dizajnuara dhe ndiqen, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga mbikëqyrësi blerës.
- B. Urdhër-blerjet boshe të numëruara janë të ruajtura (siguruara) brenda departamentit të blerjes.
- C. Blerjet normale operacionale bien në rangun prej 500€ deri në 1,000€ me dy nënshkrime kontrolli të kërkuara për blerje mbi 1,000€.
- D. Agjenti i blerjeve investon në një fond të përbashkët të tregtuar publikisht që liston aksionet e një prej furnitorëve të kompanisë në portofolin e saj.

21. Cila nga të mëposhtmet do të ju ndihmojë të siguroheni se nuk janë bërë blerje të panevojshme të stoqeve?

- A. Oferta konkurruese.
- B. Listat e çmimeve të aprovuara.
- C. Nivelet e paracaktuara të stoqeve.
- D. Kontratat e negociuara me furnitorët.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

22. Ju jeni një auditor i brendshëm që jeni caktuar në një auditim të ciklit të blerjeve së një kompanie. Për të përmbushur objektiven e auditimit për të verifikuar që transaksionet e blerjes janë të autorizuar dhe janë për materialet e nevojshme, ju duhet të:
- A. Rishikoni nënshkrimet në një mostër të raporteve pranuese.
 - B. Diskutoni një mostër të transaksioneve me agjentin e blerjeve.
 - C. Rishikoni një mostër të urdhërblerjeve dhe kërkesën përkatëse për blerje se a ka nënshkrimet e duhura.
 - D. Rishikoni një mostër të faturave të furnitorit.
23. Gjatë një analize fillestare, një auditor thekson se disa dëftesa të llogarive të pagueshme për furnitorët kryesorë tregojnë rregullime për pagesa të dyfishta të faturave paraprahe. Kjo do të dëshmonte:
- A. Nevojën për testime shtesë për të përcaktuar kontrollat përkatëse dhe ekspozimin aktual për pagesa të dyfishta të bëra ndaj furnizuesve.
 - B. Detyrimin e paregjistruar për shumën e blerjeve që nuk janë procesuar gjatë kohës që është pritur për adresën e dosjes së furnizuesit.
 - C. Mungën e kontrollit në zonën e pranimit që parandalon njoftimin me kohë në zonën e pagesave të llogarive të pagueshme që mallrat janë pranuar dhe inspektuar.
 - D. Ekzistencën e një sistemi të sofistikuar të llogarive të pagueshme që i lidh pagesat e tepërta me faturat e papaguara dhe për këtë arsye nuk kërkon shqetësim të mëtejshëm të auditimit.
24. Gjatë përgatitjes së programit të auditimit, cila nga pikat e mëposhtmet nuk është e nevojshme?
- A. Kryerja e analizës fillestare.
 - B. Rishikimi i materialitetit nga raportet paraprahe të auditimit.
 - C. Përgatitja e buxhetit që identifikon kostot e burimeve të nevojshme.
 - D. Rishikimi i standardeve të performancës të përcaktuara nga menaxhmenti.
25. Auditori përgjegjës sapo është informuar për angazhimin e ardhshëm të auditimit si dhe për ekipin e caktuar të auditimit. Zgjidhni fazën e duhur për finalizimin e buxhetimit të kohës së auditimit.
- A. Gjatë formulimit të planit afatgjatë.
 - B. Pas analizës fillestare.
 - C. Gjatë takimit fillestar të planifikimit.
 - D. Pas përfundimit të të gjithë punës në terren.
26. Një program i standardizuar i auditimit të brendshëm nuk do të ishte i përshtatshëm për cilën nga situatat e mëposhtme:
- A. Në një mjedis operativ të qëndrueshëm në të cilin ndodhin vetëm ndryshime minimale.
 - B. Në një mjedis operativ kompleks dhe të ndryshueshëm.
 - C. Në lokacione të shumta me operacione të ngjashme.
 - D. Auditimet e mëvonshme të stoqeve të kryera në lokacionin e njëjtë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

27. Një kompani prodhuese është duke u zgjeruar me shpejtësi dhe si rrjedhojë po konsideron shtimin e një linje të re prodhimi. Punonjësit aktualisht po punojnë me ndërrime (turne) të dyfishta dhe janë duke u paguar me shuma të mëdha të pagesës jashtë orarit. Aktualisht, kërkesa për të gjitha produktet e kompanisë është e lartë, por menaxhmenti është duke u shqetësuar për luhatjet e kërkesës me ndryshimet në ekonomi dhe zhvillimet teknologjike të konkurrentëve. Menaxhmenti është i shqetësuar me çështje të tilla si: nëse është duke përdorur burimet e saj në mënyrë efikase, nëse është duke u zgjeruar me shpejtësi ose jo me shpejtësi, nëse morali i punonjësve po bie dhe nëse zgjerimi i ardhshëm duhet të financohet me burime të brendshme ose nëpërmjet borxhit.

Nga kërkesat e mëposhtme të menaxhmentit drejtuar juve si auditor, cila nga të mëposhtmet është brenda fushëveprimit normal të auditimit, siç thuhet në standardet e IIA?

- A. Kryeni një vlerësim të pavarur të procesit të planifikimit të menaxhmentit si bazë për të bërë rekomandime.
- B. Bisedoni me bankat për të identifikuar alternativat e financimit dhe për të negociuar alternativat e kontratës, të cilat do t'i prezantohen menaxhmentit për vlerësim.
- C. Analizoni alternativat e financimit dhe paraqisni këto alternativa tek komiteti i auditimit.
- D. Kryeni analizën e vendimit për prodhim-ose-blerje për të përcaktuar nëse kompania duhet të nënkontrakttojë pjesët e prodhimit të saj kundrejt shtimit të kapacitetit. Raportoni rekomandimet tek menaxhmenti për miratim.

28. Një auditor i brendshëm është caktuar për të kryer një auditim të programit të sigurimeve të kompanisë, duke përfshirë përshtatshmërinë e qasjes për të minimizuar rreziqet ndaj kompanisë. Kompania ka siguruar humbjet e mëdha të viktimave të veta si dhe përfitimet shëndetësore të ofruara për të gjithë punonjësit e saj. Kompania është një firmë e madhe kombëtare me mbi 15,000 punonjës të vendosur në pjesë të ndryshme të vendit. Ajo përdor një procesor të jashtëm të kërkesave për të administruar programin e kujdesit shëndetësor. Shpenzimet mjekësore të kompanisë janë rritur me rreth 8% në vit për pesë vitet e fundit dhe menaxhmenti është i shqetësuar për kontrollin e tyre.

Supozoni se gjetjet paraprake të auditorit tregojnë se dentistë të caktuar po faturojnë përpunuesin e kujdesit shëndetësor për shërbimet që nuk janë ofruar dhe se kjo praktikë nuk po zbulohet ose pengohet nga procesori i kujdesit shëndetësor. Auditori dëshiron t'i paraqesë menaxhmentit një vlerësim të shumave të tilla. Auditori ka zgjedh një qasje që do të paraqesë pretendimet e dentistëve dhe do të verifikojë nëse pretendimet janë të përshtatshme. Qasja më e mirë për marrjen e mostrave të auditimit do të ishte:

- A. Mostrat për zbulim të cilat do të bazohen në një nivel të ulët të moderuar të pritjeve të mashtrimit
- B. Mostrat në njësi euro të të gjithë dentistëve për të përcaktuar nëse mashtrimi mund të kalojë një kufi të paracaktuar.
- C. Mostrat e veçorive për klasifikimin e ekzistencës së kërkesës së pavlefshme si devijim.
- D. Vlerësimi i variablave të kërkesave klasike të paraqitura nga dentistët e dyshuar të shtresëzuar (klasifikuar) në shumën e eurove të shërbimeve të kryera

29. Sipas Standardeve të Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA), roli i auditorit të brendshëm në lidhje me objektivat dhe qëllimet operationale, përfshin:

- A. Miratimin e objektivave operative ose qëllimeve që duhet përmbushur.
- B. Përcaktimin nëse supozimet themelore janë të përshtatshme.
- C. Zhvillimin dhe implementimin e procedurave të kontrollit.
- D. Përmbushjen e rezultateve të dëshiruara operative.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

30. Gjatë rishikimit të dokumenteve të punës së auditimit, përgjegjësia primare e mbikëqyrësit të auditimit është të përcaktojë se:
- A. Çdo fletë e punës identifikohet siç duhet me titullin përshkrues.
 - B. Fletët e punës janë referencuar siç duhe dhe janë duke u mbajtur të grupuara logjike.
 - C. Procedurat standarde të departamenteve janë të mbështetura me përgatitjen dhe teknikën e letrave të punës.
 - D. Letrat e punës mbështesin në mënyrë adekuate gjetjet e auditimit, konkluzionet dhe raportet.
31. Një letër e mirë pune në lidhje me harmonizimin (konsolidimin) bankar duhet të përfshijë (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet referencës) të gjitha nga të mëposhtmet, përveç:
- A. Pjesën (legjendën) që i tregon të gjitha shenjzimet (tick) e bëra.
 - B. Listën e çqeve të papaguara.
 - C. Listën e të gjitha depozitimeve të bëra gjatë periudhës në fjalë.
 - D. Saldon e parasë së gatshme sipas librit kryesor në datën e harmonizimit (konsolidimit) bankar.
32. Një departament i auditimit të brendshëm ka një projekt në proces për të përcaktuar nëse mund të kalojë në letrat elektronike të punës. Kriteret e vendimit do të bazohen kryesisht në kërkesat e standardeve të auditimit të brendshëm dhe në përvojën e departamenteve të tjera të auditimit.
- Cila nga efektet afatgjata, të paraqitura në vijim, lidhur me dokumentet elektronike të punës ka më shumë gjasa të ndodhë pas kalimit (konvertimit) nga dokumentet manuale të punës?
- A. Nevoja domëthënëse të trajnimit për auditorët.
 - B. Reduktime në kohën mesatare për kryerjen e auditimeve.
 - C. Letra të punës më të plota.
 - D. Letrat e punës duhet të printohen.
33. Cila nga konceptet e mëposhtme e dallon mbajtjen e dokumenteve të kompjuterizuara të punës së auditimit nga forma tradicionale e kopjes fizike?
- A. Analizat, konkluzionet dhe rekomandimet janë të fajlluara në mediat elektronike dhe si rrjedhojë i nënshtrohen kontrolleve dhe procedurave të sigurisë përmes sistemeve kompjuterike.
 - B. Mbështetja e evidente për të gjitha gjetjet kopjohet dhe i ofrohet menaxhmentit lokal dhe secilit person që merr raportin përfundimtar gjatë konferencës përmbyllëse.
 - C. Dosjet kompjuterike të të dhënave mund të përdoren në procedurat e auditimit të teknologjisë informatike.
 - D. Programet e auditimit mund të standardizohen për të eliminuar nevojën për një analizë fillestare në secilin lokacion.
34. Sipas Standardeve të IIA, gjetjet e raportuara të auditimit dalin nga një proces i krahasimit të asaj se "çfarë duhet të jetë" me "çfarë është". Në përcaktimin e asaj se "çfarë duhet të jetë" gjatë një auditimi të funksionit të thesarit të një kompanie, cila nga të mëposhtmet do të ishte kriteri më së paku i dëshirueshëm kundrejt të cilave do të gjykohen veprimet aktuale?
- A. Operacionet e funksionit të thesarit siç janë dokumentuar gjatë auditimit të fundit.
 - B. Politikat dhe procedurat e kompanisë që delegojnë autoritetin dhe caktojnë përgjegjësitë.
 - C. Ilustrimet e teksteve financiare të praktikave më të mira të thesarit të pranuar përgjithësisht.
 - D. Kodifikimi i praktikave më të mira të funksionit të thesarit në industrinë përkatëse

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

35. Një auditor ka dorëzuar draftin e parë të raportit të auditimit tek i audituari në përgatitje për një intervistë dalje. Më poshtë është një ekstrakt nga ky raport:

Auditimi u krye për të arritur disa objektiva.

Për të verifikuar ekzistencën e makinerisë së përdorur që është duke u ruajtur në depo.

Për të përcaktuar nëse makineria është dëmtuar gjatë ruajtjes në depo.

Për të rishikuar procedurat e trajtimit që kryhen nga personeli i depos.

Për të përcaktuar nëse procedurat e duhura të kontabilitetit janë duke u ndjekur për makineritë që po mbahen në depo.

Për të kalkuluar vlerën e drejtë të tregut, aktuale, për stoqet e makinave në depo.

Për të krahasuar vlerën totale të makinerisë me regjistrimet kontabël të kompanisë.

Është konfirmuar se nga 30 makinat e përzgjedhura për mostrën nga regjistrat e blerjes, 13 ishin të pranishme në katin e depos dhe 5 të tjerat ishin në bankën e ngarkesës gati për t'u transportuar në fabrikën e prodhimit. Kohë më parë, dymbëdhjetë të tjerët ishin dërguar në fabrikën e prodhimit. Një ekzaminim i procedurave të kontabilitetit të përdorura për depo zbuloi dështimin nga nëpunësi i kontabilitetit të depos për të harmonizuar regjistrimet mujore të stoqeve të makinave, ashtu siç kërkohet nga politikat e kompanisë. Një mostër prej 25 makinash u ekzaminua për dëmet e mundshme dhe të gjitha, përveç njëres, ishin në gjendje të mirë. Është konfirmuar nga auditorët se procedurat e trajtimit të përshkruara në manualin e politikës së depos duket të jenë adekuate dhe se personeli i depos me sa duket po i ndjek këto procedura, me përjashtim të ekzaminimit të aartikujve që janë marrë për inventarizim.

Gjatë komunikimit me të audituarin, ekzistojnë që të dyja, faktorët e situatës dhe karakteristikat e mesazhit që mund të dëmtojnë procesin e komunikimit. Auditori ka vetëm kontroll të kufizuar mbi faktorët e situatës, por ka kontroll të dukshëm mbi karakteristikat e mesazhit.

Elementët e mëposhtëm zakonisht përfshihen në raportet përfundimtare të auditimit: qëllimi, fushëveprimi, rezultatet, konkluzionet dhe rekomandimet. Cila nga të mëposhtmet përshkruan të gjitha elementet që mungojnë nga raporti i mësipërm?

- A. Fushëveprimi, konkluzionet, rekomandimet.
- B. Qëllimi, rezultatet, rekomandimet.
- C. Rezultatet, konkluzionet, rekomandimet.
- D. qëllimi, fushëveprimi, rekomandimi.

36. Disa nivele të menaxhmentit janë të interesuara në rezultatet e auditimit të departamentit të marketingut. Cila është metoda më e mirë e komunikimit të rezultateve të auditimit?

- A. Shkrimi i raporteve të detajuara për secilin nivel të menaxhmentit.
- B. Shkrimi i raportit për menaxhmentin e departamentit të marketingut dhe dhënia e raporteve përmbledhëse niveleve të tjera të menaxhmentit.
- C. Diskutimi i rezultateve me menaxhmentin e departamentit të marketingut dhe lëshimi i raportit përmbledhës për menaxhmentin e lartë.
- D. Diskutimi i rezultateve me të gjitha nivelet e menaxhmentit.

37. Një drejtor i auditimit të brendshëm ka vërejtur se auditorët janë duke paraqitur më shumë raporte gojore si plotësime të raporteve me shkrim. Arsyeja më e mirë për përdorimin më të madh të raporteve gojore nga auditorët është se ato:

- A. Zvogëlojnë sasinë e nevojshme të testeve për të mbështetur gjetjet e auditimit.
- B. Mund të ofrohen në mënyrë joformale pa pasur nevojë për përgatitje.
- C. Mund të përgatiten duke përdorur një format fleksibil. Si rrjedhojë, rrit efikasitetin e përgjithshëm të auditimit.
- D. Lejojnë auditorët të kundërshtojnë argumentet dhe të sigurojnë informata shtesë që palët e interesuara mund të kërkojnë.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

38. Në fillim të një auditimi, auditori i brendshëm rishikon procedurat me shkrim, të miratuara nga menaxhmenti, të cilat detajojnë ndarjen e detyrave për të forcuar kontrollet e brendshme. Këto procedura të shkruara duhet të konsiderohen si atributi (tipari) i mëposhtëm i një gjetjeje:

- A. Kriter.
- B. Gjendje.
- C. Shkak.
- D. Efekt.

39. Një gjetje e auditimit është formuluar si në vijim:

Buxheti kapital përfshin fonde për blerjen e 11 automjeteve të reja. Shqyrtimi i të dhënave të përdorimit tregoi se: 10 automjete në flotën e 70 automjeteve janë ngasur më pak se 4,000 kilometra gjatë vitit të kaluar. Automjetet iu janë caktuar grupeve të ndryshme, normat e përdorimit të të cilëve kanë ndryshuar shumë. Nuk kishte asnjë politikë që kërkon rotacionin e automjeteve midis grupeve të përdorimit të lartë dhe të ulët. Mungesa e kriterëve për caktimin e automjeteve si dhe mungesa e një sistemi për monitorimin e përdorimit të tyre mund të çojë në blerjen e automjeteve të panevojshme.

Bazuar në faktet e paraqitura në këtë gjetje, do të ishte e pështatshme që të rekomandojmë që menaxhmenti duhet të:

- A. Vendosë një minimum prej 4,000 kilometrave për tremujor si kriter për caktimin e automjeteve tek grupet e përdoruesve.
- B. Krijoj një sistem për qarkullimin e automjeteve midis përdoruesve në mënyrë periodike.
- C. Vonoj blerjen e automjeteve të propozuara derisa kapaciteti i tepërt i dukshëm të shpjegohet ose zhvlerësohet në mënyrë adekuate.
- D. Ndaloj miratimin e buxhetit kapital derisa projektet e tjera të mund të rishikohen nga auditimi i brendshëm.

40. Cila nga të mëposhtmet nuk është një avantazh i lëshimit të një raporti të ndërmjetëm?

- A. Koha e përfundimit të raportit final mund të minimizohet.
- B. Raporti i ndërmjetëm iu mundëson informatave që kërkojnë vëmendje të menjëhershme, të komunikohen.
- C. Raporti i ndërmjetëm mund të kryhet në baza joformale dhe mund të komunikohet vetëm gojarisht.
- D. Raporti formal i ndërmjetëm i shkruar mund të mohojë nevojën për një raport përfundimtar në rrethana të caktuara.

41. Auditorët e kuptojnë se veprimet korigjuese ndonjëherë nuk ndërmirren edhe kur ato dakordohen nga palët e dhura. Kjo duhet të e shtyjë një auditor të brendshëm që të:

- A. Vendos në lidhje me shtrirjen e punës së nevojshme pasuese (follow-up).
- B. Lejoj menaxhmentin të vendos se kur të kryej punë pasuese (follow-up), pasi që është përgjegjësi përfundimtare e menaxhmentit.
- C. Vendos të kryej punë pasuese (follow-up) vetëm nëse menaxhmenti kërkon ndihmën e auditorit.
- D. Shkruaj një raport të auditimit pasues (follow-up) me të gjitha gjetjet dhe rëndësinë e tyre për operacionet.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

42. Pas një vlerësimi negativ të performancës nga një mbikëqyrës, një auditor shkoi tek drejtori i auditimit për të kërkuar një ndryshim në vlerësim. Drejtori ishte i familjarizuar me performancën e auditorit dhe u pajtua me vlerësimin. Megjithatë, drejtori pranoi të takonte auditorin dhe të diskutonte lidhur me situatën. Cila nga veprimet e mëposhtme është veprimi më i mirë që drejtori duhet të ndërmarrë?
- A. Të ftoj mbikëqyrësin që të marr pjesë në takim, në mënyrë që të mos ketë keqkuptime në lidhje me faktet.
 - B. Të ftoj udhëheqësin e resurseve humane që të jetë prezent për të siguruar se nuk do të bëhen keqdeklarime.
 - C. Të takohet privatisht me të punësuarin. Të i tregojë të punësuarit se si drejtor pajtohet me vlerësimin e performancës dhe të shpreh interes në lidhje me faktet shtesë që i punësuarit mund të dëshirojë t'i paraqes.
 - D. Të takohet privatisht me të punësuarin. Të inkurajoj diskutimin duke e pyetur të punësuarin të paraqesë anën e tij të çështjes dhe të refuzojë çfarëdo marrëveshje me mbikëqyrësin.
43. Një element i autoritetit që duhet të përfshihet në statutin e departamentit të auditimit të brendshëm është
- A. Identifikimi i departamenteve operacionale të cilat departamenti i auditimit të brendshëm duhet t'i auditojë.
 - B. Identifikimi i llojeve të shpalosjeve që duhet t'i bëhen komitetit të auditimit.
 - C. Qasja në regjistra, personel dhe prona fizike relevante për kryerjen e auditimit.
 - D. Qasja në dokumentet e punës së auditorëve të jashtëm.
44. Pas emërimit, drejtori i ri i auditimit të brendshëm gjeti se një staf i papërvojë i auditimit ishte duke tejkaluar buxhetin në shumicën e auditimeve. Një rishikim i hollësishëm i dokumenteve të punës së auditimit nuk zbuloi dëshmi të rishikimeve progresive nga mbikëqyrësit e auditimit. Përveç kësaj, nuk kishte dëshmi se ekzistonte një program për sigurimin e cilësisë.
- Si një mjet për kontrollimin e projekteve dhe për të shmangur tejkalimin e buxhetit kohor, vendimi për rishikimin e buxheteve kohore për një auditim duhet të bëhet normalisht:
- A. Menjëherë pas analizës fillestare.
 - B. Kur mangësia e konsiderueshme është vërtetuar.
 - C. Kur stafi i papërvojë i auditimit caktohet në auditim.
 - D. Menjëherë pas zgjerimit të testeve për të vërtetuar besueshmërinë e gjetjeve.
45. Për shkak të dobësive të kontrollit, është e mundur që menxherët individualë të 122 restoranteve mund të kenë vendosur punonjës fiktivë në listën e pagave. Çdo restorant punëson 25-30 persona. Për të përcaktuar në mënyrë efikase nëse ky mashtrim ekziston në më pak se 1%, auditori duhet të përdorë:
- A. Mostrën sipas veçorive.
 - B. Mostrën sipas gjykimit.
 - C. Mostrën sipas drejtimit.
 - D. Mostrën për zbulim.
46. Çfarë është teknika e fetave të sallamit?
- A. Marrja e shumave të vogla të pasurive.
 - B. Përdorimi i konceptit të rrumbullakimit të fraksioneve të centëve.
 - C. Vjedhja e disa centëve nga llogaritë bankare të klientëve.
 - D. Të gjitha opsionet.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

47. Një hetues i sigurisë ose një zyrtar i zbatimit të ligjit, duhet të vëzhgojë cilën prej të mëposhtmeve gjatë hetimit të një krimi kompjuterik?
- A. Zinxhirin e ngjarjeve.
 - B. Zinxhirin e kujdestarisë (ruajtjes).
 - C. Zinxhirin e kompjuterëve.
 - D. Zinxhirin e shkrimeve.
48. Cila nga të mëposhmet nuk është aktivitet kriminal në shumicën e juridiksioneve?
- A. Shkrimi i programit të virusit kompjuterik.
 - B. Përdorimi i programit të virusit kompjuterik.
 - C. Lëshimi i programit të virusit kompjuterik.
 - D. Shpërndarja e programit të virusit kompjuterik.
49. Në një investigim (hetim) të krimit kompjuterik, dëshmia kompjuterike është:
- A. E paqëndrueshme dhe e padukshme.
 - B. E dukshme dhe magnetike.
 - C. Elektronike dhe e padukshme.
 - D. E vështirë dhe e fshijshme.
50. Mashtrimet kompjuterike rriten kur:
- A. Punonjësit nuk janë të trajnuar.
 - B. Dokumentacioni nuk është i disponueshëm
 - C. Gjurmët e auditimit nuk janë në dispozicion.
 - D. Vlerësimet e performancës së punonjësve nuk janë bërë.